


PROCESVERBAL VIII/2026



I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII (tetë) për vitin 2026 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: **KK Suharekë**
Zyra: **Salla e Bordit të Drejtorëve**
Data: **21.08.2026**
Ora : **10:00**

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Të pranishëm tjerë:

z. Flamur Bytyçi
z. Enver Shabani
znj. Mimoza Bajraktari
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Laureta Tafaj
z. Dardan Berisha

Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Zyra për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të Shkollave;**
- 4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-016-28760 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për ‘Zonën Ekonomike në Duhël’ ;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar në Komunën e Suharekës;**

Kryesuesi-para se me e hedhë në votim rendin e ditës ju njoftojë edhe për një pikë shtesë është një kërkesë nga grupi i qytetarëve të Suharekës për shpalljen Qytetar Nderi të Komunës së Suharekës për Profesorin Kastriot Bezati,e hedhë në votim rendin e ditës me pikën shtesë

Unanimisht miratohet

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Laureta Tafaj-përshendetje për të gjithë,e përgëzojë këtë projekt-vendim por desha me pyet normalisht a obligohen me nga 1€ për m² qeran në muaj e nëse po qysh kemi me ja bë për mos me pagu?

Armend Krasniqi-përshendetje për të gjithë,faktikisht ne e kemi miratu një rregullore e cila parasheh se si duhet të vepohet saktësisht në qdo dhënje në shfrytëzim të pronave Komunale ndërsa te këto 1€ për m² patjetër që duhet me u marrë një vendim për me i liru këto familje që mundemi me marrë përmes Asamblesë.

Sanie Kuçi Rexhepaj-përshendetje për të gjithë,duke pas parasysh që Komuna zakonisht e ka qëllimin që këto banesa tu jepën familjëve të Dëshmorëve,unë e di që ekziston edhe një list e

arritjes të përfituesve së ardhshëm dhe pytja ime a është respektu ajo list apo qysh ka shku si procedur e aplikimit?

Armend Krasniqi-e kemi listën konkret se si duhet veprohet në bashkëpunim me organizatat e dalura nga lufta kemi mbajtur takim dhe kemi propozu që të na sjellin emrat e këtyre familjeve.

Laureta Tafaj-ato paraprake që veq i kan marrë qysh e kan rregullu qmimin e qerave.

Armend Krasniqi-nuk ka pas rregullore të caktume dhe atëher e kemi pasë më të lehtë dmth komplet kompetenc e Komisionit.

Enver Shabani-përshendetje për të gjithë,banesën e fundit kur kemi vendos me dhën me qera ne si Komision e kemi diskutu dhe e kemi vërtetë që është qmimi shumë i lartë dhe i pa përballueshëm andaj ka pas pak konkurrenc,unë si anëtar i komisionit përveq që kërkoj në të ardhmën rregulloren me u ul qmimi propoz në formën më të mirë të mundëshme baneat që i marrin familjet e dëshmorëve me pasë të drejtë me i shitë me i ndrru,me i dhën me qera,nëse vendosim me i dhën me i shpërbly për kontributin që e kan dhën gjatë luftës është mirë me dhan kështu sepse e meritojnë.

Dardan Berisha-përshendetje për të gjithë,ju përgëzojë për punën,neve qka na mbetet si Kuvend që mos ti japim drejtim kësaj pune po e shohë që edhe kolegët dhe Drejtori kan ankesa për qmimin ,kush është kompetent për uljen e qmimit,atë që e propozoj Enveri ne nuk jemi kompetent ne krejt qka kemi kompetenc vetëm me ulë qmimin.

Avni Bytyçi-në vitin 2012 ka dalë ligji për dhënien në shfrytëzim dhe i përcakton procedurat për dhënien në shfrytëzim të pronës publike,para 2012 ne i kemi dhën diku 17 banesa në shfrytëzim dhe ja kemi kriju mundësin pa kompenzim dhe ja kemi kriju mundësin mbas 10 viteve me pas të drejtën e lëshurjes me qera dhe të drejtën për shitje,mirpo me hyrje në fuqi të ligjit kjo çështje është kufizu dhe nuk lejohet më asnjë pronë publike as me u shit as me u dhën në shfrytëzim për palen e tretë.

Flamur Bytyçi-përshendetje për të gjithë,tek çështja e çmimit po e shohë që ka zgjidhje me një vendim të Kryetarit,Asamblesë ne mundemi me nda një buxhet për me ja pagu këtyre familjeve qeran apo me një vendim me i liru.

Armend Krasniqi-banesat jan të demoluara dhe duhet patjetër me i renovu dhe në kuadër të atij vendimit nëse jan të pajtimit Asambleistat,Kryetari,Kryesuesi me ja u nda edhe nga 5000e për secilës banesë,sepse familjet që i kemi vizitu që kan apliku me të vertetë jan në gjendje të rënd dhe nuk kan mundësi as edhe 1e me i investu nëse kishim pas mundësi me gjetë një formë.

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të Shkollave;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hapë debatin

Kryesuesi-pasi që nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4. Rishqyrtimi i vendimit 01-Nr-016-28760 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi-pasi që nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit Plani Rregullues i Hollësishëm për ‘Zonën Ekonomike në Duhël’ ;

Kryesuesi- e elaboron pikën dhe hap debatin

Sanie Kuçi Rexhepaj-normalisht është një dokument shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm sidomos për bizneset e Komunës së Suharekës,në muajin Korrik të vitit kalum na veq e kemi pas një pikë të tillë të rendit të ditës dhe pak me vonesë më duket tash tek mbas 1 viti me u sjellë për shqyrtim publik ku sipas jush atëher veq ka qenë i gatshëm për shqyrtimi publik gjithsesi mirë që u mbajtë një diskutim publik shtesë para 1 muaj e gjysë përshkak se bizneset kan pas nevojë me marrë edhe më shumë informacione edhe pse në diskutim publik edhe unë kam marrë pjesë pak ka qenë i ceket diskutimi edhe nga ana e kompanis dhe vetë biznesëve po më duket po hezitojnë m marrë fjalën edhe pse po kan shumë pa qartësi,unë në diskutim publik kam qenë me monituru si Asambleiste dhe nuk kam deshtë me marrë fjalën por vetëm me pa se si po shkon procesi por prap se prap kam pas disa çështje dhe të njejtat i kam prap bonus i zonimit nuk po më duket që ka kuptim tek një zonë që është tërsisht publike ndonëse edhe Ismajli e dha një sqarim të vetin dhe nuk deshta me shty më shumë diskutimin dhe deshta me u bë çështje që mundet me u diskutu në Kuvend e jo në diskutim publik,partneriteti publiko-privat i lidhur me procedurën e bonus zonimit është procedurë që kryhet në zyrën e prokurimit,dhe në një pronë ku është publik dhe Komuna po planifikon rrugë,trotuar,zona rekreative toka është publike,parcelat që jepën në shfrytëzim nuk kan të drejtë këmbimi nuk po më duket shumë e arsyeshëme me i cekë në formën qysh është cek në këtë dokument,në këtë dokument qysh jan cekë bonuset e zonimit jan copy paste prej hartave zonale,ky është plan rregullues i hollësishëm nuk duhet me kan kurgja e përgjithsime duhet me kan gjithqka detaisht konkrete,dmth qka i përket këtij plani duhet me u diskutu,sepse secila zon e ka një karakteristik të vetën kjo është pronë tërsisht publike nuk ka prona private nuk ka kuptim bonusi zonimit nëse ka kuptim na tregoni sakt qka ka kuptim bonusi zonimit në këtë plan rregullues,për mendimin tim nuk ka kuptim,e dyta nuk më ka pëlqy kufiri autostradës që po i prekë disa parcela,parcela që ki me e dhën në shfrytëzim, nëse ki me i dhën 30 ari një biznesi po i thu që 15 ri nuk ki drejtë me i shfrytëzu për objektë për arsye se e ki kufirin e autostradës,në planifikim nuk më ka pëlqy qysh është planifiku qekjo pjesë,dhe tek zona e gjelbërimit e kam pas vrejtje në dëgjim publik për mendimin tim zona industriale duhet me pas kogja gjelbërim rreth e rreth zonës sepse zonat industriale jan zona ku bëhet imetimi ndotësve të ajrit dhe nëse ajo zonë nuk rrethohet me gjelbërim për mbrojtjen e ajrit për komplet parcelat tjera që jan për rreth atëherë qka kemi bë në planifikim,sasia e gjelbërimit për mendimin tim nuk është e mjaftueshëme.

Visar Kuçi-është fazë e shqyrtimit publik.

Dardan Berisha-një pyetje sa është sipërfaqja e saktë e zonës ekonomike në Duhël që ka me u dhën në shfrytëzim?

Visar Kuçi-104 ha e 72 ari që ka me u dhën në shfrytëzim

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit paraprak për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Flamur Bytyçi-drejtori nuk qenka këtu i kam disa pyetje lidhur me këtë kërkesë,arsye që e shoh shpeshë në vendime pse don me dhën Komuna është përfitimi ekonomik realisht duhet me pas një përshkrim më të madh tek përfitimi ekonomik sa është ai përfitim dhe realisht nuk e kam të qartë qfar zone rekrativ atje kur nuk ke as banor nëse mundet dikush me na tregu pak më gjerësishtë.

Laureta Tafaj-prej dallim nga Flamuri unë mendojë pak më ndryshe,nuk e di kush e qka ka me bë konkretisht mirpo ai ka me dorzu një plan qysh ka me u funksionalizu ajo zonë,mirpo në secilin vend në Komunën tonë është një parcelë tu nejtë dhe dikush kërkon me marrë në shfrytëzim dhe

donë me bë diqka hala ma gjelbëruese kurr nuk është shumë gjelbrimi në jetën e njeriut kështu që unë pajtohem dhe jam pro e këtij vendimi.

Sanie Kuçi Rexhepaj-për mu ka shumë pa qartësi ky projekt-vendim përshkak se në kërkesën e Drejtorit thotë që ka shumë interesim për këtë zonë,dhe nuk na tregon qfar interesimi është konkretisht përshkak se destinimi në këtë zonë është zon rekreative turistike gjelbërim,por këtë rekreative turisike ju po mundoheni me zbërthy në forma të tjera të biznesit që për mu në këtë rast nuk po më duket e arsyeshëmr,pajtohem me Lauretën që tokat publike nuk është mirë me i lën pjerrina mirpo në këtë rastë ndoshta më mirë është Komuna me investu në mbjelljen e drunjëve ë atë zonë sesa me ja dhën dikujtë tjetër që nuk e dijmë për qka ka me u dhën,dmth ne kemi paqartësi dhe për këtë arsye po tërhiqemi mbrapa deri sa të na jepni sqarimet e nevojshme që qfar interesimi ka prej qytetarëve për me marrë në shfrytëzim këtë pjesë,përpos asaj në projekt-vendim po ceket që një pjesë e parcelës ka me u dhën dhe skica është te kërkesa e Drejtorit që e ka bë po në fakt ajo pjesë nuk po besojë që është infrastruktur rrugore,nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lartë për dhënjën në shfrytëzim të parcelës 11500m2 për ushtrimin veprimtaris zonë rekreative turistike,gjelbërim dhe pjesërisht infrastruktur rrugore,ne infrastruktur rrugore nuk kemi nevoj me dhën në shfrytëzim,këtu edhe projekt vendimi nuk është në rregull por edhe vet kërkesa e Drejtorit nuk është e arsyeshme.

Kryesuesi- e hedhë në votim

4 për,2 kundër,1 abstenim miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit lokal të veprimit për riintegrimin e personave të riadhesuar në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi-e elaboron pikën dhe hap debatin

Kryesuesi-pasi që nuk ka debat e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 8.Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen qytetarë nderi;

Kryesuesi- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Takimi përfundoi : 11:00